

**V E N D I M**  
**Nr.245, datë 27.5.1993**

**PËR DEKLARIMIN E PAVLEFSHMËRISË SË DISA VENDIMEVE TË QEVERISË DHE  
MIRATIMIN E NJË FONDI PËR PROKURORINË E PËRGJITHSHME**

Me propozimin e Prokurorisë së Përgjithshme, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Deklarimin e pavlefshmërisë së vendimeve të Këshillit të Ministrave për dërgimin dhe shitjen jashtë shtetit të një sasie ari dhe argjendi gjatë viteve 1988-1990, si vijon: vendimet e Këshillit të Ministrave nr.5, datë 7.11.1988; nr.430, datë 7.12.1988, nr.84, datë 8.3.1989, nr.8, datë 25.1.1990; nr.225, datë 5.7.1990; nr.271, datë 4.8.1990 dhe nr.429, datë 13.12.1990 pasi janë shkelur procedurat ligjore të marrjes së vendimeve.

2. Prokurorisë së Përgjithshme i shtohen 450 mijë lekë fond page që do të përdoret për grupin e ekspertëve kontabël për çështjen penale në ngarkim të ish-udhëheqësve të lartë partiakë e shtetërorë. Shuma të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave në Buxhetin e Shtetit për vitin 1993.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Aleksandër Meksi**